

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti i Mjekesise

Lëndët/Pozitat: 34

1. Fizioterapia te personat me amputim të gjymtyrëve (BSc)
2. Fizioterapia në neurologji I (BSc)
3. Fizioterapia në neurologji II (BSc)
4. Praktikë Klinike IV (BSc)
5. Praktikë Klinike V (BSc)

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtareve):

- **Kryetar: Prof. asst. Merita Qorolli**
- **Anëtar Prof. asst. Eqrem Gara**
- **Anëtar Prof. asst. Samire Beqaj**

**UNIVERSITETI I PRISHTINES "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I MJEKËSISË
PRISHTINË**

Pranuar me: 04.09.2024			
Ni. org.	Numër	Shtetia	Vlera
	6746		

Kandidatët e paraqitur sipas pozitive/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rëndor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitive apo kandidatëve):

1. Artan Jaka
2. Mejdi Aliu
3. Rilind Shala
4. Riad Bejta
5. Miranda Bellanica Shatri
6. Veton Osmanaj
7. Esmire Tershnjaku Sadiku
8. Hajrie Zejnullahi
9. Fitim Sadiku
10. Lirije Oruqi
11. Albinot Gërvalla
12. Valmira Bajrami
13. Visar Bllaca

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).

Në bazë të konkursit Publik të shpallur në Universitetin të Prishtinës "Hasan Prishtina" për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm, me numër 2/426, të datës 25.07.2024 dhe rregullores me nr.2/254, të datës 17.07.2024, për procedurat e përzgjedhjes ku kërkohet pranimiti i një bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime në lëndët: Fizioterapia te personat me amputim të gjymtyrëve (BSc) Fizioterapia në neurologji I (BSc), Fizioterapia në neurologji II (BSc), Praktike Klinike IV (BSc) dhe Praktike Klinike V (BSc).

Mbështetur në dokumentacionin e parashtruar konsiderojmë se **Rilind Shala**, fizioterapeut, MSc, i plotëson më së miri kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur në pozitën numër 34 për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Fizioterapia te personat me amputim të gjymtyrëve (BSc), Fizioterapia në neurologji I (BSc), Fizioterapia në neurologji II (BSc), Praktike klinike IV(BSc) dhe Praktike klinike V (Bsc) pasi që studimet Bachelor (nota mesatare 9.47) dhe studimet Master (nota mesatare 10.00) i ka në fushën fizioterapisë, dëshmon aktivitet shkencor me publikime në revista shkencore të fushës së fizioterapisë të indeksuara në platformën Scopus, si dhe dëshmon shpërblime për arritje shkencore nga Institucionet relevante akademike dhe profesionale.



- Kandidati Artan Jaka, doktor i mjekësisë, nuk i plotëson kushtet pasi që nuk i ka të përfunduar studimet në fushën e fizioterapisë.
- Kandidati Mejdi Aliu është propozuar të zgjedhet në pozitën 33.
- Kandidati Riad Bejta MSc, PhD cand., refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, meqenëse nuk ka dorëzuar vendimin për nostrifikimin e diplomës së studimeve Master, por vetëm aplikim.
- Kandidatja Miranda Bellanica Shatri fizioterapeute, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë përparësi kanë kandidatët të cilët i kanë të përfunduara studimet Master në fushën e

Fizioterapisë, ndërsa kandidatja ne fjale ka përfunduar Master ne Edukimin ne Kujdesin Shëndetësor pranë UP-se.

- Kandidati Veton Osmanaj refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë përparësi kanë kandidatët të cilët i kanë të përfunduara studimet Master ne fushën e Fizioterapisë, ndërsa kandidati ne fjale ka përfunduar Master ne Edukimin ne Kujdesin Shëndetësor pranë UP-se.
- Kandidatja Esmire Tershnjaku Sadiku refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë nuk e plotëson kriterin e moshës, sipas Statutit te Universitetit te Prishtinës (neni 154, pika 1.2).
- Kandidatja Hajrie Zejnullahi, fizioterapeute, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, meqenëse propozohet kandidati Rilind Shala MSc, i cili, bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, i plotëson më mire kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur në pozitën numër 34.
- Kandidati Fitim Sadiku, fizioterapeut, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, meqenëse propozohet kandidati Rilind Shala MSc, i cili, bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, i plotëson më mire kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur në pozitën numër 34.
- Kandidatja Lirije Oruqi, fizioterapeute, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë nuk e plotëson kriterin e moshës, sipas Statutit te Universitetit te Prishtinës (neni 154, pika 1.2).
- Kandidati Albinot Gërvalla, fizioterapeut, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë nuk e plotëson kriterin e moshës, sipas Statutit te Universitetit te Prishtinës (neni 154, pika 1.2).

- Kandidatja Valmira Bajrami, fizioterapeute, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë studimet Master nuk i ka të përfunduara në fushën e Fizioterapisë si dhe nuk e plotëson kriterin e moshës, sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës (neni 154, pika 1.2).
- Kandidati Visar Bllaca, fizioterapeut, MSc, refuzohet për t'u zgjedhur në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ushtrime në lëndët e lartpërmendura, meqë nuk e plotëson kriterin e moshës, sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës (neni 154, pika 1.2).

I propozojmë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë, që kandidati **Rilind Shala, MSc**, të zgjedhët në pozitën numër 34 për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime në lëndët: Fizioterapia të personat me amputim të gjymtyrëve (BSc), Fizioterapia në neurologji I (BSc), Fizioterapia në neurologji II (BSc), Praktike Klinike IV dhe Praktike Klinike V.

Pozita	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
Kryetar	Prof.asst. Merita Qorolli	
Anëtar	Prof.asst. Eqrem Gara	
Anëtar	Prof.asst. Samire Beqaj	